

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurit Xh. B., me venbanim në Gj., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 2153/2015, të datës 08.12.2015, të cilën e përfaqësonte Prokurorja Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 16.11.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri, Xh. B. nga i ati S. , e ëma R., e lindur K., i lindur ... në fshatin D., me vendbanim në Gj., Lagja "... " Rrp.nr. ku dhe jeton, ka të kryer shkollën ... , i pa punë , i martuar-baba i ... fëmijëve, i gjendjes ekonomike të varfër, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprën tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën2015, në objektin (shtëpinë e tij) në Gj. i pandehuri me qëllim të vetit ti sjellë përfitime të kundërligjshme pasuror, nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-Distribucioni në Gjilan, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike në atë mënyrë që i njëjti është lidhur direkt jashtë njësorit matës me një kabllo me të cilin ka furnizuar një lavatriqe, me ç'rast ka dëmtuar të dëmtuarën KEDS, me shum prej 20.72 euro,

-me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73, 75 dhe 80 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit Xh. B., për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditë, dhe me gjobë prej 200 euro,

Në bazë të nenit 80 të KPRK-s, të akuzuarit Xh. B. i shqiptohet dënimi kumulativ me burg në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditë, si dhe dënim me gjobë prej 200 euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresorë.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 16.11.2016, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Kujtesa Fazliu në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

E dëmtuara KEDS-deklaron: i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të pandehurit dhe paraqesë kërkesë pasurore-juridike ndaj tij.

I pandehuri Xh. B. deklaron: e ndiej veten fajtor dhe më vjen shumë keq për rastin që ka ndodhur dhe i kërkoj falje të dëmtuarës për rastin që ka ndodhur, më parë nuk kam kryer vepra penale dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, jam mbajtës i familjës ... antarshe jam i gjendjës së varfër ekonomike dhe i pa punë dhe e lus gjykatën që të më shqiptojë një denim sa ma të butë

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari Xh. B. ka deklaruar e pranojë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjykata, pas dëgjimit të Prokurorit dhe të dëmtuarës, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari Xh. B. në objektin (shtëpinë e tij) në Gjilan i pandehuri me qëllim të vetit ti sjellë përfitime të kundërligjshme pasuror, nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-Distribucioni në Gjilan, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike në atë mënyrë që i njëjti është lidhur direkt jashtë njëisorit matës me një kabllo me të cilin ka furnizuar një lavatriqe, me ç'rast ka dëmtuar të dëmtuarën KEDS, me shum prej 20.72 euro,

në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi për të cilën është përgjegjës penalisht.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata të pandehurin Xh. B. e shpalli fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale në fjalë dhe se për të njëjtën është përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP-s, si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen e mirë të akuzuarit gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, se është mbajtës i vetëm i familjes 7 anëtarëshe, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale kurse si rrethanë rënduese, të merret shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore të kësaj vepre penale

Sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi kumulativ me kusht, ndaj të akuzuarit Xh. B. është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke u paralajmëruar me rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilat duhet plotësuar që dënimi me kusht mos të revokohet duke u shëndërruar në dënim efektiv.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 23/2016, Më .16.11.2016

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njejtit, pëmes kësaj Gjykate.